



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



# Përgjigje ndaj komenteve të palëve të interesit

Mekanizmi i mbështetjes për caqet shtesë të BRE-ve  
(20 MW solare fotovoltaike)

## DEKLARATË

Këto përgjigje janë përgatitur nga ZRRE-ja vetëm për qëllime informative. Dokumenti nuk duhet të konsiderohet se paraqet vendim të ZRRE-së.

**5 korrik 2019**



Artikulli Referenca	Komentuesi	Komentet e pranuar	Përgjigjet e ZRRE-së
<p><b>Shkresa e datës 15 May 2019</b></p> <p><b>REG-KS/O/03/15-05-2019</b></p>	<p><b>Sekretariati i Komunitetit të Energjisë</b></p>	<p>Komentet e Sekretariatit janë të fokusuara në aspektin parimor të mbështetjes së BRE-ve dhe jo decidivisht në çështjet teknike të paraqitura në Raportin Konsultativ për 20MW solare.</p> <p>Sekretariati ka përshëndetur ambicien e Kosovës për të arritur një objektiv të vullnetshëm të BRE-së prej 29% dhe një objektiv shtesë për energjinë diellore prej 20 MW. Megjithatë ka rekomanduar që mënyra e mbështetjes/subvencionimit të jetë më efektive duke qenë edhe në përputhje me ndihmën shtetërore të acquis të Komunitetit të Energjisë.</p> <p>Sekretariati ka shprehur qëndrimin se mbështetja e BRE-ve nga shteti duhet të synojë të promovojë përdorimin e energjisë elektrike nga BRE, por jo duke mbështetur padrejtësisht prodhuesit e BRE-ve në dëm të konsumatorëve. Kjo arrihet më së miri duke lehtësuar konkurrencën midis zhvilluesve të besueshëm të BRE-ve gjatë aplikimit të Ndihmës shtetërore. Konkurrenca është një mjet transparent për të identifikuar nivelin e mbështetjes që duhet të ofrohet për BRE-të dhe për të zgjedhur projektet për të cilat ofrohet mbështetje.</p>	<p>ZRRE ka trajtuar me mjaft kujdes reagimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Zyrës së BE-së në Kosovë, USAID, Ambasadës Gjermane në Kosovë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Meqenëse në parim të gjitha palët kanë qëndrime të njëjta, atëherë ZRRE do të japë përgjigje të përbashkëta për palët e lartpërmendura.</p> <p>Që prej vendosjes së obligimeve ligjore për nxitjen e investimeve në BRE, ZRRE ka trajtuar me mjaft kujdes këtë sektor, duke krijuar mekanizma të përshtatshëm për kohën dhe rrethanat ekonomiko-sociale të Kosovës. Mekanizmat e krijuar nga ZRRE për mbështetjen e BRE-ve kanë rezultuar të jenë efikas, duke nxitur interesim të madh për investime dhe kohë pas kohe i ka përshtatur këtyre mekanizmave ndryshimet ligjore dhe kushtet e të bërit biznes në Kosovë dhe rajon.</p> <p>Megjithatë, zhvillimi i teknologjisë patjetër që ka ndikim edhe në politikat e Kosovës në drejtim të mbështetjes së BRE-ve, duke i orientuar në masë të pranueshme kah tregu i energjisë dhe duke lejuar tregun që të përcaktoj se çfarë çmime do të ishin të arsyeshme për energjinë e prodhuar nga BRE. ZRRE pajtohet që tregu është mekanizmi i duhur i cili përcakton kostot e investimeve dhe çmimin e energjisë, përmes mënyrave konkurruese të mundësisë së barabartë për investime ndaj të gjithë investitorëve potencial.</p>



<p><b>Shkresa e datës 15 May 2019</b></p> <p><b>REG- KS/O/03/ 15-05- 2019</b></p>	<p><b>Sekretariati i Komunitetit të Energjisë</b></p>	<p>Sekretariati ka dhënë si shembull rastin e Malit të Zi ku projektet e BRE tashmë janë duke u zhvilluar pa asnjë mbështetje shtesë nga shteti.</p> <p>Gjithashtu si një shembull të kohëve të fundit në rajonin e Komunitetit të Energjisë, i është referuar ankandeve të mbajtura në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 2018 ku mbështetja për ndërtimin e një centrali diellor prej 100 MW arriti një nivel prej 59.9 EUR/MW për 50 MW (ndërsa 50 MW e mbetur do të ndërtohen pa mbështetje shtetërore).</p> <p>Në fund të reagimit të tij, Sekretariati shprehet:</p> <p><i>“Meqenëse është detyrë e autoritetit rregullator për të mbrojtur konsumatorët dhe për këtë arsye të shmangët mbi-kompensimi i investitorëve, Sekretariati ju inkurajon fuqishëm që të mos e vendosni përkrahje për caqet shtesë administrativisht siç theksohet në raport për konsultim publik, por me anë të një procedure të ofertave konkurruese”.</i></p>	<p>ZRRE me datë 27.06.2017 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka pranuar Udhëzimin e ri Administrativ 05.2017, ku në shtojcën I. të këtij udhëzimi ka pranuar ndryshimin e caqeve nga energjia solare prej 10 MW sa ishin me udhëzimin e kaluar, të shtuara edhe 20 MW të reja. Poashtu ka pranuar edhe ndryshimin e Biomassës nga 14 MW në 20 MW.</p> <p>Ministria e Zhvillimit Ekonomik, bazuar në Ligjin për Energji Nr. 05/L-081 në nenin 13 është përgjegjëse për zhvillimin e politikave nga BRE, dhe në paragrafi 1 të këtij Neni citoj” Ministria përcakton me akt të veçantë nënligjor caqet e energjisë nga BRE-të...”</p> <p>ZRRE, bazuar në Nenin 8 gjegjësisht paragrafin 9 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike citoj” Rregullatori sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, harton metodologjitë për përcaktimin e tarifave që duhet të paguajnë furnizuesit, për energjinë elektrike të prodhuar nga Burimet e ripërtitëshme. Kjo metodologji duhet të përfshij dispozita për kompensimin e furnizuesve, për kostot shtesë të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga këto burime të energjisë”.</p> <p>Zyra e Rregullatorit për Energji, bazuar në nenin 43 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, udhëheq procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapacitete të reja gjeneruese e cila është e bazuar në Direktivës Nr. 2009/72 të EU të transpozuar në Legjislacionin primar.</p> <p>ZRRE, për të plotësuar edhe obligimet ligjore ka harmonizuar Rregullën për Skemën Mbështetëse e cila është harmonizuar me kërkesat ligjore në 27 prill 2017 sipas legjislacionit primar.</p>
-----------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



<p>Shkresa e datës 16 maj 2019</p>	<p><b>Zyra e BE-se në Kosovë</b></p>	<p>Zyra e BE-së në Kosovë përmes një letre ka paraqitur edhe qëndrimet e saj në lidhje me trajtimin e 20 MW shtesë solare të cilat janë vënë si cak vullnetar nga ana e Qeverisë së Kosovës në udhëzimin administrativ 05/2017.</p> <p>Zyra e BE-së në Kosovë mbështet fuqishëm zhvillimin e BRE-ve në Kosovë dhe njeh të arriturat e konsiderueshme në nxitjen e investimeve në sektorin e VRE-ve, mirëpo kjo duhet të bëhet përmes mekanizma të qëndrueshëm afatgjatë.</p>	<p>Duke i pasur për bazë, obligimet ligjore të cilat janë në fuqi dhe që kanë dal si obligim në vitin 2017 përmes aktit juridik të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, duke mos u përcaktuar saktë nga Ministria se cilat janë obligative dhe vullnetare si në Shtojcën I. të udhëzimit, ka trajtuar këto caqe me tarifën nxitëse të aplikuar në vitin 2017, mirëpo procesi i trajtimit ka pasur vonesa edhe në mungesë të kuorimit të Bordit, sepse në të kundërtën këto caqe kanë vlejtur për atë periudhë ku shumica e shteteve edhe në rajon dhe Europë e kanë aplikuar Tarifën Nxitëse.</p> <p>Konkluzionet e Këshillit të Ministrave të datës 14 dhjetor 2017, gjegjësisht pika 10 ku ftohen palët kontraktuese që të punojnë ngushtë me sekretariatit dhe BREZH-in, në hartimin dhe zbatimin e një procesi konkurrues... , kanë ardhur saktësisht 6 muaj pasi që MZHE e ka rishikuar Udhëzimin Administrativ dhe ka caktuar caqet solare +20 MW, duke mos i definuar a janë obligative apo vullnetare ashtu siç po supozohet.</p> <p>ZRRE, konsideron se për caqet tjera që do të dalin nga Komuniteti i Energjisë, për periudhën 2021-2030 do të kërkoj nga institucionet e shtetit të Kosovës që bëjnë ndryshimet e nevojshme ligjore të legjislacionet primar dhe sekondar, dhe në pajtim me ligjet në fuqi do ti zbaton edhe format e përshtatshme të skemave mbështetëse. Ndërsa skema aktuale sipas UA Nr. 05/2017 do të vlen vetëm për caqet deri 2020.</p> <p>Bordi i ZRRE ka paraqitur qëndrimin e tij ligjor të zbatueshëm aktualisht dhe ka konkluduar se raporti konsultativ të zhvillohet përmes Tarifës Nxitëse (Feed-in Tariff). Andaj edhe konsultimi publik është aranzhuar sipas kësaj qasje.</p>
------------------------------------	--------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



<p>Shkresa e datës 16 maj 2019</p>	<p><b>Zyra e BE-se në Kosovë</b></p>	<p>BE rikujton edhe një herë ZRRE-së se raporti i Implementimit i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (ECS) të vitit 2018 paraqet përparimin e arritur në përmbushjen e objektivit të detyrueshëm prej 25% deri në vitin 2020, prandaj mbështetja përmes subvencionimit të zhvillimit të kapacitetit shtesë të BRE-së, të bazohet në procedurat/mekanizmat konkurrues, që do të lejonte të shmangte kompensimin e tepërt të investitorëve. Ekzistojnë projekte shembull në rajon, në Shqipëri dhe në Mal të Zi, që kryhen në bazë të procesit të tenderimit me pak ose aspak mbështetje nga shteti.</p> <p>Ne inkurajojmë ZRRE-në që të avancojë promovimin e energjisë së rinovueshme në Kosovë përmes procesit konkurrues të ofertave sipas Udhëzimeve për Ndhmën Shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe energjinë 2014-2020</p>	
------------------------------------	--------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--



<p>Shkresa e datës 16 maj 2019</p>	<p><b>Ambasada Gjermane në Prishtinë</b></p>	<p>Ambasada Gjermane në Prishtinë ka shprehur qëndrimet e saj në lidhje me trajtimin e 20 MW shtesë solare, me anë të një shkrese.</p> <p>Ambasada supozon që Kosova përpiqet të arrijë dy objektiva në politikën e saj të ripërtëritshme të energjisë: a) të përmbushë detyrimet e saj në përmbushjen e objektivave të energjisë së ripërtëritshme sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe b) ta bëjë këtë në një mënyrë që minimizon koston për qytetarët e Kosovës dhe në buxhetin e Kosovës.</p> <p>Ambasada është e bindur se kjo arrihet më së miri duke u lejuar zhvilluesve të projekteve të konkurrojnë për subvencion qeveritar, për shembull nëpërmjet ankandeve. Konkurrenca është një mënyrë transparente për të zbuluar nivelin më të ulët të subvencioneve që Kosova duhet të paguajë për të arritur ndonjë MË shtesë të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Një qasje e tillë gjithashtu i nxit zhvilluesit e projektit për të zhvilluar projekte me kosto efektive, siç është treguar në shumë shembuj ndërkombëtarë, së fundi në Shqipëri në 2018, por edhe në Gjermani.</p>	
------------------------------------	----------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--



	<b>Ambasada Gjermane në Prishtinë</b>	<p>Ambasada Gjermane sygjeron që të implementohet mekanizëm konkurrues i përzgjedhjes së investimeve në BRE, duke shprehur shqetësimin se praktika e kaluar e Kosovës për shpërndarjen e licencave për projektet diellore prej 3 MW në bazë të parimit “i pari që aplikon, i pari pajiset me autorizim” mbart një rrezik për korrupsion dhe presion të panevojshëm nga zhvilluesit jo-kredibil në qeveri dhe në ZRRE.</p> <p>Ambasada, inkurajon fuqimisht ZRRE-në që të mos vendosë një tarifë nxitëse përmes një vendimi administrativ, siç sugjerohet në raport për konsultime publike, por të përdor një procedurë konkurruese të ofertimit me qëllim identifikimin e subvencionimit minimal të nevojshëm për 20 MW shtesë të energjisë solare fotovoltaike.</p>	
--	---------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--



<p>Shkresa e datës 23 maj 2019</p>	<p><b>USAID</b></p>	<p>USAID ka shprehur qëndrimet e saj në lidhje me trajtimin e 20 MW shtesë solare, me anë të një shkrese dërguar Rregullatorit.</p> <p>USAID ka theksuar mbështetjen e vazhdueshme ndaj Rregullatorit, për të krijuar dhe zbatuar kornizë ligjore dhe rregullative të qëndrueshme dhe të parashikueshme, duke konsideruar si parakusht për investime në sektorin e energjisë në Kosovë.</p> <p>USAID thekson se nuk mbështet Tarifën nxitëse të propozuar për 20MW shtesë dhe nuk mbështet asnjë skemë të tarifës nxitëse për kapacitete të cilat janë jashtë cakut obligativ prej 25%.</p> <p>USAID gjithashtu shpjegon që caqet obligative për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, ndër tjera, janë vendosur duke marrë në konsideratë potencialet e vendeve respektive dhe mundësinë e subvencionimit në mënyrë të qëndrueshme.</p> <p>USAID vlerëson arritjet e deritashme të ndërtimit të kapaciteteve të reja, mirëpo paraqet shqetësimin se Tarifa nxitëse e propozuar për kapacitet shtesë Solare fotovoltaike nga Rregullatori, nuk adreson në mënyrë të duhur paqartësinë dhe pasigurinë në politikat shtetërore të krijuara nga UA 05/2017 i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, as nuk adreson në mënyrë të sigurtë ndikimin e caqeve vullnetare në çmimet e konsumatorëve fundor të energjisë elektrik.</p>	
------------------------------------	---------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--





<p>Shkresa e datës 23 maj 2019</p>	<p><b>USAID</b></p>	<p>USAID i rekomandon ZRRE-së, që të inicioj konsultime shtesë me të gjitha palët, për të aplikuar mekanizma të bazuar në treg, të cilat kanë dëshmuar të jenë shumë efektive dhe kanë ulur koston e konsumatorëve për skemat mbështetëse. Gjithashtu USAID përmes kësaj shkrese ka informuar, që veprimet e ZRRE-së në lidhje me këtë çështje, mund të merren parasysh, derisa USAID është duke planifikuar programin e ri të asistencës teknike për sektorin e energjisë në Kosovë në përgjithësi dhe ZRRE-së në veçanti.</p>	<p>ZRRE vlerëson shumë lart mbështetjen e vazhdueshme të USAID-it dhe të gjithë donatorëve tjerë për sektorin e energjisë në Kosovë në përgjithësi dhe për Rregullatorin në veçanti, duke qenë partnerë serioz që prej themelimit të Rregullatorit.</p> <p>ZRRE është e përkushtuar që të zhvilloj dhe të implementoj kornizë të qëndrueshme rregullative, duke respektuar obligimet që dalin nga direktivat evropiane dhe mirëpret mbështetjen e të gjithë akterëve, me qëllim të krijimit të një ambienti të qëndrueshëm, ku interesat e konsumatorëve dhe palëve tjera të sektorit të energjisë, balancohen në mënyrë të duhur.</p>
------------------------------------	---------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



<p>Shkresa e datës 19 maj 2019</p> <p>Nr. Prot. 1239</p>	<p><b>Ministria e Zhvillimit Ekonomik</b></p>	<p>Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Z. Lluka, ka dërguar një shkresë me anë të së cilës ka paraqitur komentet në Raportin Konsultativ për trajtimin e 20MË shtesë solare fotovoltaike.</p> <p>Ministri ka theksuar prioritetin e Qeverisë, ku krahas sigurisë së furnizimit me energji elektrike, ka edhe diversifikimin e burimeve të gjenerimit dhe tranzicionin gradual në Burime të Ripërtëritshme, e cila njëherit është edhe obligim kontraktual nga Komuniteti i Energjisë. Ai paraqet shqetësimin e reflektimit të tarifave të konsumatorëve të energjisë, e cila prekë direkt mirëqenien e qytetarëve.</p> <p>Ministri ka shprehur shqetësimin se Tarifa Nxitëse e propozuar është shumë e lartë dhe duhet të rishikohet në mënyrë që të kemi cmim sa më të ulët duke pasur theks të veçant në mirëqenien sociale të qytetarëve të vendit.</p> <p>Për më tepër Ministri thekson që format e Tarifës Nxitëse, nuk janë duke u aplikuar më në asnjë nga vendet e rajonit dhe rekomandon të gjinden modalitete tjera të bazuara në treg, të cilat rrjedhin si rekomandim i Këshillit të Ministrave.</p>	
----------------------------------------------------------	-----------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--



Artikulli Referenca	Komentuesi	Komentet e pranuar	Përgjigjet e ZRRE-së
Pika 1	<b>Eling Prishtinë</b>	Kompania Eling konstaton se rënia e çmimit në teknologjinë e paneleve solare e përfshinë diku prej <b>30-40%</b> të kostos së projektit dhe kjo teknologji ka rënë në çmim tek prodhuesit e ndryshëm diku afërsisht <b>20%</b> .	Eling nuk ka paraqitur konkretisht se për cilat vite çmimi i paneleve solare fotovoltaike ka rënë për 20%, ku vetëm për dy vitet e fundit, çmimi mesatar i moduleve ka rënë për 32%. Megjithatë ZRRE rikonfirmon që niveli i çmimeve të paneleve solare fotovoltaike është duke rënë ndjeshëm nga viti në vit dhe sipas trendit të zhvillimit të teknologjisë, pritet që energjia solare të mos ketë më fare nevojë për subvencionim sepse si rrjedhojë e zhvillimit teknologjik (ku përfshihet rënia e kostos dhe ngritja e efikasitetit të shfrytëzimit) do ta bëjë këtë teknologji konkurrenente në treg me të gjitha teknologjitë tjera konvencionale. Për ilustrim mund të ju marrim projekte në rajon (Shqipëri e Mal të Zi) ku investime të tilla janë duke u bërë pa asnjë subvencionim të çmimit apo disa me mbështetje minimale.
Pika 2	<b>Eling Prishtinë</b>	Eling vlerëson se Invertorët sipas trendëve që janë duke shkuar ka zbritje në këtë teknologji diku prej <b>5-7%</b> tek prodhuesit e ndryshëm.	Edhe invertorët kanë pësuar rënie të konsiderueshme ngase janë zhvilluar paralelisht me zhvillimet teknologjike të paneleve solare. Vetëm në dy vitet e fundit, çmimet mesatare për PV Invertor kanë rënë për 18% (Smart Energy International).



Pika 3	<b>Eling Prishtinë</b>	Eling konstaton se pjesa përcjellëse tjetër siç janë: mbajtësit e paneleve, le që nuk kanë zbritje mirëpo momentalisht kanë ngritje në çmim sepse çmimi i metaleve ka ngritje në berzë dhe ajo është thuaja e pa ndryshuar.	Sikurse edhe shumë nga komentet të cilat janë paraqitur nga Eling, as këtu nuk ka ndonjë referencë në ndonjë nga bursat kredibile të metaleve. Ne kemi analizuar aspektin e trendit të çmimit të metaleve në vitet e fundit dhe mund të themi që çmimi i tyre ka pësuar rënie në vitet e fundit. Nuk mund të merren muaj të caktuar kur këto çmime mund të jenë më të larta, ngase edhe periudha e investimeve nuk është aq e shkurtër dhe investitorët nuk janë të shtyrë që të kontraktjnë materialet gjatë kohës kur çmimet arrijnë nivele të larta. Për më tepër edhe një nga qëllimet e përcaktimit të tarifave nxitëse është që të nxis investime me kosto minimale dhe që i gjithë procesi i investimeve të zhvillohet në atë mënyrë ku investitori do të arrinte të përmbyllte investimin me koston më të ulët të mundshme.
Pika 4	<b>Eling Prishtinë</b>	Eling bën të ditur se trafostacionet të cilat janë pjesë integruese e parkut poashtu llogariten ne berzë e cila momenalisht është e pafavorshme.	Termi i pafavorshëm është shumë relativ dhe i padefinuar nga komentuesi. Megjithatë ZRRE dëshiron të sqaroj që në kalkulimin e koston së investimit ka marrë për bazë të gjitha kostot dhe se niveli i Tarifën nxitëse të propozuar mbulon kostot dhe siguron një kthim të investimit brenda një periudhe prej 7-10 vite, e cila është më se e arsyeshme duke konsideruar jetëgjatësinë e një impianti solar prej 20 -25 vite. Kjo i bije që përveç gjatë periudhës së MBE-së, ku do të ktheheshin të gjitha investimet dhe do të gjenerohej profit, edhe pas maturitetit të MBE-së, për më shumë se 10 vite, një impiant i tillë do të gjeneronte të hyra dhe profit të konsiderueshëm, ngase gjithçka që do të barte kosto, do të ishte vetëm operimi dhe mirëmbajtja e impiantit.



Pika 5	<b>Eling Prishtinë</b>	Sipas Eling kabllot, pjesët përcjellëse ( ndriçim, rrethoja etj) të cilat nevojiten për ndërtimin e parkut prap nuk kanë zbritje dhe nuk janë në trend të rënies në çmim.	Përkundër që komentuesi nuk ka dhënë asnjë referencë se sa mund të jetë kjo kosto, ZRRE sqaron që kjo pjesë e koston paraqet një pjesëmarrje të ulët në projekt dhe çfarëdo niveli i çmimit të këtyre pjesëve nuk do të kishte ndikim signifikant në koston e përgjithshme të projektit.
Pika 6	<b>Eling Prishtinë</b>	Sipas Eling poashtu kostoja e tokës ndërtimore ku bëhet ndërtimi i parqeve të tilla, nuk është në trend të rënies së çmimit.	ZRRE dëshiron të sqaroj që toka në të cilën mund të bëhen investime të tilla është tokë e cila nuk ka vlerë të madhe bujqësore dhe as industriale. Me një fjalë kjo do të duhej të ishte toka me vlerën më të ulët në treg. Për më tepër ZRRE inkurajon investitorët që të mos investojnë në toka të cilat do të mund të përdreshin për kultivime të ndryshme bujqësore apo edhe për qëllime tjera komerciale.
Pika 7	<b>Eling Prishtinë</b>	Eling thekson se varësisht prej pozicionit ku ndërtohet parku, kyçja në rrjetin elektrik është një problem që tërheqë me vete kosto të madhe.	ZRRE ka llogaritur edhe aspektin e kyçjes në rrjet dhe ka kalkuluar kosto të arsyeshme për këtë qëllim. Meqenëse projekti i cili është marrë si referent për këtë shqyrtim, është një park solar me kapacitet prej 3 MW, i cili në kushte normale do të kyçej në nivel të Distribucionit dhe nuk bartë kosto të lartë të projektit.
Pika 8 <i>Përlllogaritja e WACC-ut</i>	<b>Klubi i Prodhuesve të Kosovës</b>	Klubi i prodhuesve të Kosovës kundërshton të marre si baze krahasimore Hungarinë për llogaritjen e WACC-ut. Ky konstatim bazohet në tabelat e listuara nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës ku vërehet se Kosova është vend me riskun më të lartë në rajon, siç mund të shihet edhe klasifikimi nga ana e OECD-së së ekspozimit të riskut për huadhënie në Kosovë.	Çështja e përcaktimit të WACC është vendosur gjatë shqyrtimit të vlerave hyrëse në vitin 2018 dhe si i tillë i është nënshtruar një procesi të gjatë të konsultimit publik me të gjitha palët e interesit. Të gjitha dokumentet përcjellëse, duke përfshirë edhe komentet e palëve të interesit dhe përgjigjet e ZRRE ndaj këtyre komenteve mund ti gjeni të publikuara në faqen zyrtare të ZRRE-së.



<p>Pika 9 <i>(tabela 1.5)</i></p>	<p><b>Klubi i Prodhuesve të Kosovës</b></p>	<p>Klubi i prodhuesve të Kosovës duke iu referuar tabelës 1.5 përfshirë këtu vlerat per: normat pa risk, koston e borxhit, koston e ekuitetit, beta, huamarrjet dhe ekuiteti., vjen në përfundim se bazuar në parametrat e cekur më lart WACC para tatimit duhet të jetë <b>10.6%</b></p>	
<p>Pika 10 <i>Investimet kapitale</i></p>	<p><b>Klubi i Prodhuesve të Kosovës</b></p>	<p>Klubi i prodhuesve të Kosovës vlerëson se investimet kapitale të përcaktuara nga ZRre për 1 MW për impiantet fotovoltaike është shumë e ulët në relacion me kosto reale për investim në këtë fushe. Këtij konstatimi i shoqërohet tabela 2.1 ku ilustruhet kostoja reale e investimeve bazuar në oferta nga vetë prodhuesit me vlerën e <b>TOTAL CAPEX për 1 MW prej 947,500 Euro.</b></p>	<p>ZRRE ka analizuar me kujdes komentet e Klubit të prodhuesve. Duhet të sqarohet edhe një herë që projekti referent në analizat e ZRRE për propozimin e Tarifës nxitëse është një impiant solar me kapacitet të instaluar prej 3MW. Është e njohur që me rritjen e kapacitet të instaluar mbi 1 MW, kosto marxhinale për çdo MW shtesë të instaluar brenda projektit, do të bjerë, që i bijnë që kosto për njësi (MW) është më e ulët sa më i madh të jetë kapaciteti instalues.</p>



<p>Pika 11</p> <p><i>Shpenzimet operative</i></p>	<p><b>Klubi i Prodhuesve të Kosovës</b></p>	<p>Klubi i prodhuesve të Kosovës duke u bazuar ne tabelën 3.1 vlerëson se kostot operationale ne baze te CAPEX te përlllogaritura ne tabelën 2.1 janë <b>10-12%</b> ne proporcion me investimet për 1MË te instaluar. Per dallim nga ZRre qe i ka përcaktuar shpenzimet operationale si <b>2-3 %</b> te vlerës se investimit.</p>	<p>Sipas komentit të Klubit të Prodhuesve i bije që vetëm kosto e operimit dhe mirëmbajtjes përgjatë jetëgjatësisë së projektit do të ishte për të paktën 2 herë më e lartë se kosto totale e investimit. Kështu për periudhën 20 vjeçare, vetëm operim dhe mirëmbajtje për një impiant solar me kapacitet prej 3MW do të kushtonte 3.6 milion euro, apo nëse jetëgjatësia e impiantit arrin në 25 vjet kjo kosto do të ishte afër 5 milion euro. Nëse kjo do të ishte e saktë, investime të tilla nuk do të ishte fizibile për tu subvencionuar.</p> <p>ZRRE dëshiron të sqaroj që kosto e operimit dhe mirëmbajtjes së impianteve solare në vendet evropiane nuk arrin më shumë se 2-3% të koston së investimit, ndërsa në Kosovë, duke marrë për bazë edhe nivelin ekonomik dhe aspekte të tregut të punës, operimi dhe mirëmbajtja mund të realizohet edhe me nën 2% të koston së investimit. - ZRRE ka propozuar që kjo të jetë në nivelin prej 2% te investimit të përgjithshëm.</p>
<p>Pika 12</p> <p><i>Tarifa nxitëse</i></p>	<p><b>INDEP</b></p>	<p>INDEP kundërshton miratimin e feed-in tarifë për 20 MW solare fotovoltaike pasi Udhëzimi Administrativ 05/2017 ka qenë joligjor.</p>	<p>Aspekti i legjitimitetit të udhëzimit Administrativ 05/2017 do duhej të adresohet në Qeverinë e Kosovës.</p>
<p>Pika 13</p>	<p><b>INDEP</b></p>	<p>INDEP kërkon të ulet kostoja e përlllogaritur e mirëmbajtjes nga <b>2-3%</b> në <b>1%</b> në vit.</p>	<p>Megjithëse INDEP mund të ketë të drejt në raste specifike, që kjo kosto do të mund të ishte edhe 1%, megjithatë ZRRE ruan qëndrimin e saj fillestar në lidhje me koston për operim dhe mirëmbajtje.</p>



<p>Pika 14</p> <p><i>Përlllogaritja e WACC-ut</i></p>	<p><b>INDEP</b></p>	<p>INDEP kërkon që të ulet kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit në së paku <b>7.5%</b>. Duke u bazuar në nivelin e rritjes së kredihënies për biznese në Kosovë dhe vlerëson se ky fakt duhet të merret parasysh.</p>	<p>Çështja e përcaktimit të WACC është vendosur gjatë shqyrtimit të vlerave hyrëse në vitin 2018 dhe si i tillë i është nënshtruar një procesi të gjatë të konsultimit publik me të gjitha palët e interesit. Të gjitha dokumentet përcjellëse, duke përfshirë edhe komentet e palëve të interesit dhe përgjigjet e ZRRE ndaj këtyre komenteve mund të gjeni të publikuara në faqen zyrtare të ZRRE-së.</p>
<p>Pika 15</p>	<p><b>INDEP</b></p>	<p>INDEP bën me dije se edhe nëse pranojnë një WACC prej <b>8.4%</b>, LCOE sipas tyre nuk duhet të jetë më shumë se <b>80</b> euro.</p>	<p>ZRRE ka pranuar komente të ndryshme nga shumë akter, nga të cilët, disa sugjerojnë një Tarifë nxitëse më të lartë se propozimi i saj dhe disa (siç është edhe INDEP) sugjerojnë që tarifa duhet të jetë më e ulët se ajo e propozuar fillimisht nga ZRRE. Duam të sqarojmë që opinione të ndryshme (për dhe kundër) do të ketë çfarëdo niveli i tarifës që të merret, prandaj duke u bazuar në projekte konkrete të realizuara në vend dhe në rajon, në shumë studime të kohëve të fundit rreth zhvillimit të teknologjisë dhe rritjes së efikasitetit si dhe duke marrë për bazë edhe aplikacione të investitorëve potencial që kanë aplikuar për autorizime në ZRRE, mund të themi që propozimi fillestar i tarifës nxitëse prej 90.4€/MWh është i arsyeshëm dhe se me një tarifë të tillë, investimet në impiante solare fotovoltaike janë mjaftueshëm të subvencionuar.</p>





<p>Pika 16</p> <p><i>Tarifa nxitëse</i></p>	<p><b>SHERK</b></p>	<p>SHERK kundërshton miratimin e tarifës nxitëse për BRE-te nga ana e ZRrE duke e konsideruar si jo të favorshme për investitorë. Sipas analizës nga ana e SHERK, Shpenzimet Kapitale për <b>1 MW</b> fuqi të instaluar variojnë nga <b>1.05</b> deri në <b>1.1 Milionë</b> euro dhe si rrjedhojë sugjerojnë që një tarife nxitëse nën <b>100 Euro</b> nuk është ekonomike dhe nuk e arsyeton një investim të tillë.</p>	<p>ZRRE ka trajtuar me kujdes shkresën e SHERK në lidhje me propozimin e ZRRE për mbështetjen e 20MW shtesë të energjisë solare fotovoltaike. Megjithatë SHERK në shkresën e tij nuk ka paraqitur asnjë argument të bazuar në lidhje me koston e investimeve të cilës i referohet prej mbi 1 milion euro e as për tarifën nxitëse prej 100 €/MWh.</p> <p>ZRRE dëshiron të theksojë që propozimi fillestar i tarifës nxitëse prej 90.4€/MWh është i arsyeshëm dhe se me një tarifë të tillë, investimet në impiante solare fotovoltaike do të ishin mjaftueshëm të subvencionuara. ZRRE nuk ka qëndrim tjetër dhe nëse kjo nuk do të jetë e pranueshme në asnjë mënyrë dhe investimet do të dështojnë si pasojë e tarifës nxitëse, atëherë do të kërkohen forma tjera konkurruese për përcaktimin e nivelit të çmimit, siç janë ankandet.</p>
---------------------------------------------	---------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------